



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.12, datë 03.12.2020

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT DHE
NDRYSHIMIN E SUBJEKTIT ZHVILLUES, PËR OBJEKTIN:
“VAZHDIMI I LUNGOMARES – SEGMENTI JUGOR NGA FUSHAT E SPORTIT DERI
TEK TUNELI, BASHKIA VLORË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 12, 13 dhe 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Vlorë dhe Z. Artur Shehu, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe subjektit zhvillues për objektin: “Vazhdimi i Lungomares – segmenti jugor nga fushat e sportit deri tek tuneli, Bashkia Vlorë”, të miratuar me Vendimin Nr.02, datë 08.11.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Subjekti zhvillues i objektit të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, ndryshohet nga “Bashkia Vlorë” në “Bashkia Vlorë dhe Z. Artur Shehu”.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.02, datë 08.11.2019, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit për projektin e miratuar, do të lëshohen veçmas për secilin prej zhvilluesve, sipas pjesëve takuese në plan-vendosje, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Shkëmbimit me Kusht Nr.988 Rep, Nr.646 Kol, që kanë nënshkruar dy zhvilluesit më datë 17.09.2020, pas miratimit të dhënë me vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 62, datë 05.08.2020.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Belinda Balluku
BELINDA BALLUKU



[Signature]
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

